(shtuar me vendimin nr. 891, datë 27.12.2022)

VENDIM
Nr. 569, datë 17.7.2019

PËR MIRATIMIN E KOMPETENCAVE, MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT
(ndryshuar me VKM nr. 165, datë 17.3.2021; nr. 804. datë 20.12.2021; nr. 891, datë 27.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 93/2015 "Për turizmin", të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (në vijim AKB), si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin (në vijim ministri), me seli në Tiranë.

2. AKB-ja financohet nga buxheti i shtetit, donacione të huaja dhe burime të tjera të ligjshme. Buxheti i AKB-së përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për turizmin.

3. AKB-ja ka për mision mbrojtjen dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të të gjithë potencialit ekzistues të zonës bregdetare e detare dhe pasurive mjedisore që përfshihen brenda saj, si dhe kontrollin e veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

II. KOMPETENCAT/PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT

AKB-ja ka këto kompetenca/përgjegjësi:

a) Sigurimin e performancës në zonat bregdetare;

b) Organizimin e punës për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;

b/1) Sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet ofrimit të shërbimit të pastrimit gjatë sezonit turistik, sipas kreut III/1, të këtij vendimi;

c) Organizimin e punës për nxitjen e investimeve në zonën bregdetare;

ç) Organizimin e punës për bashkërendimin e programeve, të projekteve zhvilluese me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;

d) Sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet inspektimit dhe kontrollit të veprimtarive turistike.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT

1. AKB-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në zonat, territoret, objektet e veprimtaritë që ndodhen ose zhvillohen, tërësisht ose pjesërisht, apo kanë ndikim në zonën bregdetare të Republikës së Shqipërisë.

2. AKB-ja organizohet në dy nivele:

a) në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;

b) në nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) agjencive rajonale.

3. Ministri miraton me urdhër shtrirjen territoriale të agjencive rajonale dhe qytetin/qarkun ku do të ngrihet agjencia rajonale.

4. AKB-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson agjencinë në marrëdhënie me të tretë. Agjencitë rajonale drejtohen nga drejtuesit përkatës.

5. Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit miratohet nga Kryeministri, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

6. AKB-ja, në përputhje me kompetencat/përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:

a) Krijon dhe përditëson Inventarin Kombëtar të Zonës Bregdetare;

b) Jep kontribut në informimin, konsultimin dhe aksesin e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave e të strategjive të lidhura me menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;

c) Merr pjesë në hartimin e politikave e të strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e tyre;

ç) Propozon ndryshime dhe përmirëson kuadrin ligjor e nënligjor për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;

d) Bashkëpunon me organet përkatëse për projektet dhe aktivitetet për mbrojtjen e zhvillimin e bregdetit dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

dh) Nxit dhe bashkëpunon me organizma, institucione, investitorë dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë apo vendas dhe i fton ata për pjesëmarrje e përfshirje në projektet dhe zhvillimet me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;

e) Monitoron zbatimin me përpikëri të instrumenteve të planifikimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore e vendore në zonën bregdetare;

ë) Kontrollon zbatimin e kritereve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;

f) Ushtron kontroll dhe inspekton në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike;

g) Inspekton dhe monitoron rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare dhe respektimin e rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare;

gj) Inspekton dhe kontrollon zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi;

h) Merr masa, vendos gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit;

i) Shqyrton ankesat për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve;

j) Ndjek procesin e ekzekutimit të detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura, me qëllim arkëtimin e shumave në favor të institucionit;

k) Lajmëron organet shtetërore kompetente në rastet kur vërehen shkelje administrative, veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin, duke u propozuar organeve përkatëse marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës, si dhe përgatit kallëzimin penal për veprat penale të vëna re gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

l) Vlerëson nevojat dhe harton buxhetin vjetor e afatmesëm të institucionit;

ll) Siguron burimet njerëzore dhe garanton zhvillimin – trajnimin e tyre në përputhje me kërkesat e pozicionit të punës, si dhe kryen vlerësimin e performancës;

m) Mirëmban pajisjet dhe asetet në dispozicion për zhvillimin e veprimtarisë;

n) Kryen detyra të tjera të dhëna me akte ligjore dhe nënligjore.

6/1. Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit krijohet Komisioni i Ankimit të AKB-së, i cili drejtohet nga drejtori i përgjithshëm dhe, si rregull, ka në përbërje të tij:

a) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për performancën dhe menaxhimin e integruar të zonave bregdetare;

b) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit të zonave bregdetare;

c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për shërbimet mbështetëse;

ç) nëpunësin përgjegjës për çështjet juridike/ligjore të agjencisë, në cilësinë e sekretarit të Komisionit të Ankimit të AKB-së.

6/2. Në mungesë të anëtarëve të komisionit të përcaktuar në pikën 6.1 të këtij kreu, për shkak të mosplotësimit të pozicionit të punës, drejtori i përgjithshëm cakton zëvendësuesin e njësisë përgjegjëse respektive, deri në plotësimin e vendit vakant.

6/3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Komisionit të Ankimit të AKB-së përcaktohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKB-së.

7. Agjencitë rajonale të bregdetit kryejnë këto detyra:

a) Përgjigjen para drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së për zbatimin e detyrave të përcaktuara nga drejtoria qendrore e AKB-së;

b) Bashkëpunojnë për sigurimin e informacionit për ngritjen dhe përditësimin e Inventarit Kombëtar të Zonës Bregdetare;

c) Monitorojnë zbatimin me përpikëri të instrumenteve të planifikimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore e vendore në zonën bregdetare, si dhe raportimin e situatës në drejtorinë qendrore të AKB-së;

ç) Kontrollojnë zbatimin e kritereve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;

d) Ushtrojnë kontroll dhe inspektimin në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike;

dh) Inspektojnë dhe monitorojnë rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare, dhe respektojnë rregullat për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare;

e) Inspektojnë dhe kontrollojnë zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi;

ë) Marrin masa, vendosin gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit;

f) Inspektojnë dhe kontrollojnë zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi.

8. AKB-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të marrë nga organet e tjera shtetërore, qendrore e vendore, të gjithë ndihmën dhe të dhënat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve që i janë caktuar. Institucionet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me AKB-në, të shkëmbejnë të dhëna dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë për përmbushjen e qëllimeve e të funksioneve gjatë veprimtarisë së saj.

9. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKB-së miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

10. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve të AKB-së rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

11. AKB-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e AKB-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

12. Agjencitë rajonale të bregdetit kanë stemën, logon dhe vulën e tyre zyrtare. Stema e agjencive rajonale përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Rajonale e Bregdetit... (emri i qarkut/qytetit ku ka selinë agjencia)", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Vula e AKB-së dhe vula e secilës agjenci rajonale të bregdetit kanë formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III/1 SIGURIMI I SHËRBIMIT TË PASTRIMIT GJATË SEZONIT TURISTIK

(shtuar me vendimin nr. 891, datë 27.12.2022)

1. Për qëllim të këtij kreu, "zonë bregdetare" konsiderohet territori që përfshin vijën bregdetare, bregun e detit, zonën urbane përreth bregut të detit, deri ku kufizohet me rrugën kombëtare.

2. Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare kryhet në mbështetje dhe plotësim të shërbimit të ofruar nga organet kompetente të qeverisjes qendrore apo të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe nuk prek kompetencat e tyre të përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi. Agjencia Kombëtare e Bregdetit lidh marrëveshjen përkatëse, pjesë e së cilës është edhe plani i pastrimit të territorit, me organet kompetente të qeverisjes qendrore apo njësitë e vetëqeverisjes vendore për sigurimin e mbështetjes dhe plotësimit të shërbimit të pastrimit të zonës bregdetare, vetëm për periudhën e specifikuar në këtë vendim.

3. Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare sigurohet për periudhën 15 qershor deri më 15 shtator.

4. Përjashtimisht për sezonin turistik të vitit 2022, shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare sigurohet vetëm për bashkitë Durrës, Kavajë, Himarë dhe Sarandë, sipas hartave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

4/1. Përjashtimisht, për sezonin turistik të vitit 2023, shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare sigurohet vetëm për bashkitë Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Himarë dhe Sarandë, sipas hartave që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

5. Procedura e prokurimit publik për sigurimin e shërbimit të pastrimit të zonës bregdetare bëhet nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, duke zbatuar legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të AKB-së, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, struktura aktuale vazhdon funksionimin e saj sipas strukturës dhe organikës të miratuar.

2. Numri i punonjësve, asetet dhe fondet e miratuara për AKB-në dhe agjencitë rajonale riorganizohen sipas AKB-së, në nivel qendror e rajonal.

3. Nëpunësit civilë aktualë të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, të cilët kryejnë funksionet e inspektimit për kundërvajtjet administrative në fushën e turizmit, funksione të cilat kalojnë në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, transferohen pranë AKB-së, në zbatim të legjislacionit të nëpunësit civil, në rastin e mbylljes e të ristrukturimit të institucioneve.

4. Vendimi nr. 31, datë 22.1.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

(shtuar me vendimin nr. 891, datë 27.12.2022)

(shtuar me VKM nr. 804, datë 20.12.2021)

Bashkia Durrës / Harta e zonës bregdetare që nevojitet të pastrohet:

BASHKIA DURRES
PLAZHI I MADH
Sip. 1,728,830 m2
Gjatesia 6,880 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 450 m
Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
SH4
Arapaj
Bari, IT - Durres, AL
SH56
Beach of Durres
Shkalinur
SH4
SHKEMBI I KAVAJËS
Google Earth
Image © 2021 TerraMetrics
Image © 2021 Maxar Technologies
N
1 mi

BASHKIA DURRES
GJIRI I LALZIT
Sip. 5,275,880 m2
Gjatesia 6,730 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 900 m
Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
Plazhi Hamallaj
Google Earth
Data SIO, NOAA, U.S. Navy, NGA, GEBCO
Image © 2021 TerraMetrics
Image © 2021 Maxar Technologies
N
2 mi

Bashkia Kavajë / Harta e zonës bregdetare që nevojitet të pastrohet:



Bashkia Sarandë/ Harta e zonës bregdetare që nevojitet të pastrohet:

BASHKIA SARANDE
KSAMIL-SARANDE
Sip. 8,862,850 m2
Gjatesia 11,800 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 272 m & 1484 m nga rruga kryesore.
Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
SH98
SH81
Dritas
Pilakë
Kulluriçë
Vurgu i Ri
Peristeres Περιστερές
Plazhi Ksamilit
Ksamil
Google Earth
2 mi
N


BASHKIA SARANDE
KSAMIL-SARANDE
Sip. 8,862,850 m2
Gjatesia 11,800 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 272 m & 1484 m nga rruga kryesore.
Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
SH81
Plazhi Ksamilit
Ksamil
Google Earth
3000 ft
N

Bashkia Himarë/ Harta e zonës bregdetare që nevojitet të pastrohet:

BASHKIA HIMARE
PALASE
Sip. 544,655 m2
Gjatesia 840 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 175 m & 1900 m nga rruga kryesore.
Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
SH8
SH8
Plazhi i Palasës
Google Earth
Image © 2021 Maxar Technologies
3000 ft
N

BASHKIA HIMARE
LUKOVE
Sip. 218,530 m2
Gjatesia 1,260 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 80 m & 1200 m nga rruga kryesore.
Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
SH8
SH8
SH8
Lukovë - Shpellë
Taverna Dashi
Αγίου Νικολάου
Rruga Shpella Lukovë
Lukova Beach
The Element
Google Earth
Image © 2021 TerraMetrics
Image © 2021 CNES / Airbus
Image © 2021 Maxar Technologies
2000 ft
N

BASHKIA HIMARE
LLAMAN
Sip. 33,500 m2
Gjatesia 190 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 70 m & 580 m nga rruga kryesore
Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
SH8
Llaman
Llamani Beach
Submarine Bay 105
Google Earth
Image © 2021 CNES / Airbus
1000 ft
N

BASHKIA HIMARE
LIVADH
Sip. 183,920 m2
Gjatesia 1280 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 80 m & 1310 m nga rruga kryesore
Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
Himarë-Livadh Rr.
Aphrodite Garden Room & Apartment
Varrezat
SH8
Kastrati Oil
Camping Moskato
Himarë
Miamar
Livadi Beach
Livadhi Beach
Blue Bay Himare
Himara Hostel
Google Earth
Image © 2021 CNES / Airbus
2000 ft
N

BASHKIA HIMARE
JALE
Sip. 164,700 m2
Gjatesia 885 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 300 m
Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
SH8
Jale Beach
Google Earth
Image © 2021 Maxar Technologies
Image © 2021 CNES / Airbus
3000 ft
N

BASHKIA HIMARE
HIMARE QYTET
Sip. 133,520 m2
Gjatesia 1920 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 170 m
Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
Himare
Spile Beach
Plazhi i Himares
Stagelo Beach
Plazhi i Maraçit
Primos Beach
Taverna Stolis
Plazhi i Potamit
Rapos Resort
Potam Beach
Sun Bakers Hostel
EOS Mezze Bar
Hotel Panorama
SH8
Google Earth
Image © 2021 CNES / Airbus
2000 ft
N

Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
Palasa Beach
SH8
GJILEKE
KONDRAQ
Dhermi
Sanur Beach House
Dhermiu Beach
BASHKIA HIMARE
DHERMI-DRIMADHE
Sip. 973,860 m2
Gjatesia 5,360 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 205 m & 1130 m nga rruga kryesore.
Google Earth
Image © 2021 TerraMetrics
Image © 2021 Maxar Technologies
N
4000 ft

BASHKIA HIMARE
BUNEC
Sip. 99,670 m2
Gjatesia 1,035 m/linear
Thellesia nga deti ne toke 120 m & 1080 m nga rruga kryesore.
Legend
RRUGA KYESORE
ZONAT E PROPOZUARA PER PASTRIM
SH8
MEMA RESTORANT
Bar Restorant Ansi
Bunec Beach Resort
Buneci Beach
Taverna Nikolas
Perla Cafe
Church of St. Nifona
Google Earth
Image © 2021 TerraMetrics
Image © 2021 Maxar Technologies
N
2000 ft


GJIRI I LALZIT
BASHKIA DURRËS
Sip. 5,275,880 m2
Gjatësia 6,730 m/linear
Distanca nga deti në tokë 930 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.5 1 2 Km
Lalëz
Hidrovori
456000
461000
459000
460000


CURRILA-KALLM
BASHKIA DURRËS
Sip. 81,760 m2
Gjatësia 1,260 m/linear
Distanca nga deti në tokë 100 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.1 0.2 0.4 Km
451000
452000
4577000
4578000

CURRILA
BASHKIA DURRËS
Sip. 140,000 m2
Gjatësia 1,720 m/linear
Distanca nga deti në tokë 100 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.125 0.25 0.5 Km
451600
452600
457600

PLAZHI I MADH
BASHKIA DURRËS
Sip. 1,728,830 m2
Gjatësia 6,880 m/linear
Distanca nga deti në tokë 470 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.425 0.85 1.7 Km
Arapaj
Shkallnur
455600
460600
457600
457060

PALASË
BASHKIA HIMARË
Sip. 544,655 m²
Gjatësia 840 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,900 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.125 0.25 0.5 Km
464060
465060
466060
4448000
4449000


DHËRMI-DRIMADHË
BASHKIA HIMARË
Sip. 973,860 m2
Gjatësia 5,360 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,130 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.25 0.5 1 Km
Gjileke
Dhërmi
465600
466600
467600
468600
469600
4445000
4446000
4447000

(shtuar me vendimin nr. 891, datë 27.12.2022)

LIVADH
BASHKIA HIMARË
Sip. 183,920 m2
Gjatësia 1,280 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,310 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.125 0.25 0.5 Km
475600
476600
477600
444000
444200

HIMARË
HIMARË QYTET
Sip. 133,520 m2
Gjatësia 1,920 m/linear
Distanca nga deti në tokë 170 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.1 0.2 0.4 Km
478100
478600
479100
479600
4440500
4440000

LLAMAN
BASHKIA HIMARË
Sip. 33,500 m2
Gjatësia 190 m/linear
Distanca nga deti në tokë 580 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.1 0.2 0.4 Km
N
479100
479600
480100
480600
443900
443850
443800

QEPARO
BASHKIA HIMARË
Sip. 93,200 m2
Gjatësia 1,640 m/linear
Distanca nga deti në tokë 440 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.1 0.2 0.4 Km
N
484100
484600
485100
485600
4435000
4435500

BORSH
BASHKIA HIMARË
Sip. 422,620 m2
Gjatësia 4,660 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,960 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.35 0.7 1.4 Km
Borsh
Qazim Pali
Qeparo Fushë
485600
490600
4435000

BUNEC
BASHKIA HIMARË
Sip. 99,670 m2
Gjatësia 1,035 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,080 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.075 0.15 0.3 Km
490600
491600
4430000


LUKOVË
BASHKIA HIMARË
Sip. 218,530 m2
Gjatësia 1,260 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,200 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.175 0.35 0.7 Km
490600
491600
492600
493600
4427000
4428000

(shtuar me vendimin nr. 891, datë 27.12.2022)




KARPEN
BASHKIA KAVAJË
Sip. 183,000 m2
Gjatësia 1,300 m/linear
Distanca nga deti në tokë 185 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.1 0.2 0.4 Km
455600
456600
4561000
Karpeni i ri


4416000
4415000
499600
498600
SARANDË QYTET
(PLLAKAT)
BASHKIA SARANDË
Sip. 255,205 m²
Gjatësia 1,800 m/linear
Distanca nga deti në tokë 250 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.1 0.2 0.4 Km
N

(shtuar me vendimin nr. 891, datë 27.12.2022)


KSAMIL
BASHKIA SARANDË
Sip. 7,890,160 m2
Gjatësia 7,890 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,500 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.5 1 2 Km
N
Çukë
Dritas
Vurgu i Ri
495600
500600
505600
4412000
4407000


KSAMIL 1
BASHKIA SARANDË
Sip. 1,989,766 m2
Gjatësia 2,200 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,400 m
Ksamil
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.175 0.35 0.7 Km
498600
499600
500600
4405000
4404000
4403000


SPILLE
BASHKIA RROGOZHINË
Sip. 1,829,005 m2
Gjatësia 7,880 m/linear
Distanca nga deti në tokë 380 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.5 1 2 Km
450600
455600
455200
454700
Stërbeg
Shardushk
Spanesh
Spille
Patkë-Milot
Rreth-Greth
Vilë-Ballaj


AKERNI
BASHKIA VLORË
Sip. 813,636 m2
Gjatësia 2,640 m/linear
Distanca nga deti në tokë 300 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.2 0.4 0.8 Km
445600
446600
447600
448600
449000
449200


449600
450600
451600
4485000
4484000
ZVËRNEC
BASHKIA VLORË
Sip. 439,941 m2
Gjatësia 2,500 m/linear
Distanca nga deti në tokë 300 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.15 0.3 0.6 Km

(shtuar me vendimin nr. 891, datë 27.12.2022)

PLAZHI I VJETËR
BASHKIA VLORË
Sip. 666,202 m2
Gjatësia 2,800 m/linear
Distanca nga deti në tokë 360 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.15 0.3 0.6 Km
453600
454600
455600
448000
448100
448200


LONGOMARE-UJI I FTOHTË
BASHKIA VLORË
Sip. 998,868 m2
Gjatësia 4,385 m/linear
Distanca nga deti në tokë 295 m
Kaninë
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.375 0.75 1.5 Km
453600
454600
455600
456600
457600
458600
459600
447600
447700
447800
447900
448000


RADHIMË-ORIKUM
BASHKIA VLORË
Sip. 2,301,621 m2
Gjatësia 10,800 m/linear
Distanca nga deti në tokë 580 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.75 1.5 3 Km
445600
450600
455600
4467000
4472000
Radhimë
Tragjas

(shtuar me vendimin nr. 891, datë 27.12.2022)

Bashkia	Vendndodhje	Sipërfaqja	Gjatësia	Gjerësia	Fillim i Plazhit (Veri)		Mbarim i Plazhit (Jug)	
		(m2)	(m/linear)	(m)	Koordinata E	Koordinata N	Koordinata E	Koordinata N
Durrës	Gjiri i Lalzit	5,275,880	6,730	640-930	459151.21	4600734.80	459676.09	4594050.09
	Currila-Kallm	81,760	1,260	30-100	451429.89	4578075.84	451548.54	4576832.95
	Currila	140,000	1,720	30-100	451855.71	4576719.11	452677.86	4575257.30
	Plazhi i Madh	1,728,830	6,880	120-470	455699.27	4575812.64	459887.15	4570390.09
Himarë	Palasë	544,655	840	176-1900	466229.79	4449130.53	464869.13	4447984.61
	Dhërmi-Drimadhe	973,860	5,360	205-1130	465725.44	4447453.95	470001.74	4444538.52
	Jalë	164,700	865	150-350	474530.63	4443288.51	474700.49	4442547.28
	Livadh	183,920	1,280	80-1,310	476663.07	4442413.17	477032.01	4441020.93
	Himarë	133,520	1,920	55-170	478025.69	4440818.93	479058.27	4439577.59
	Llaman	33,500	190	70-580	480145.48	4439057.13	480188.04	4438402.52
	Qeparo	93,200	1,640	52-440	485056.50	4435833.35	484017.53	4435248.32
	Borsh	422,620	4,660	100-1,960	487222.29	4436658.44	489363.83	4432238.60
	Bunec	99,670	1,035	120-1,080	490505.93	4430346.48	490904.76	4429442.18
	Lukovë	218,530	1,260	80-1,200	492726.91	4428340.45	492605.63	4426203.34
Kavajë	Golem-Qerret	3,490,160	6,730	380-730	459576.01	4570519.13	458072.53	4564194.15
	Karpen	183,000	1,300	84-185	456520.79	4561580.95	455870.81	4560420.93
Sarandë	Qytet(Pllakat)	255,205	1,800	30-250	498587.10	4415988.70	500061.78	4414869.19
	Qytet	418,748	3,000	50-280	500827.45	4415541.85	502198.81	4412567.96
	Ksamil	7,890,160	7,890	100-1500	501761.71	4412876.97	500703.12	4405213.92
	Ksamil1	1,989,766	2,200	1000-1400	500586.36	4405202.54	499788.84	4402862.72
Rrogozhinë	Spille	1,829,005	7,880	30-380	454205.31	4553721.43	453783.63	4546159.69
Vlorë	Akerni	813,636	2,640	120-300	447007.59	4492780.08	447577.93	4490136.99
	Zvërnec	439,941	2,500	80-300	449813.47	4485536.65	451783.83	4483565.44
	Zvërnec 1	1,504,170	4,800	45-700	450741.05	4485435.94	454069.38	4481959.07
	Plazhi i Vjetër	666,202	2,800	125-360	454088.68	4481980.29	455751.74	4479990.82
	Lungomare-Uji i Ftohtë	998,868	4,385	60-295	456449.52	4479990.32	455945.16	4475432.62
	Radhimë-Orikum	2,301,621	10,800	50-580	455949.32	4475419.26	451144.61	4464795.97